

Lënda Inovacion

Arsimtar : GjyltenSuma

Njesia:Ushtrime:Teknikat promovuese dhe marketingu me internet

Çfarë është Internet Marketing? - LinkedIn

Pse Internet Marketing është i rëndësishëm?

Interneti ka fuqinë për të lidhur miliona njerëz në të gjithë botën. Por gjithashtu ka kapacitetin që ta dërgojë biznesin tënd tek miliona njerëz në mënyrë të targetuar, në të gjithë botën. Një ane tjetër pozitive, që e bën këtë biznes akoma dhe më të mirë është që nuk ju nevojiten shumë para për ta realizuar qëllimet tuaja të promovimit, krahasuar me format tradicionale të marketingut.

Gjithashtu efekti i fushatave të reklamimit online është lehtësisht i matshëm duke përdorur analitikat e webi-t dhe mjete të tjera matëse, të cilat vihen në dispozicion nga platformat e përdorura për një transparencë sa më të lartë për përdoruesit. Kjo mënyrë raportimi të jep mundësinë për të parë kthimin nga investimi (ROI) që ti dëshiron për biznesin tënd.

Mundësitë për ta promovuar biznesin në mënyrë sa më të shpejtë dhe të targetuar drejt klientëve potencialë janë më shumë se kurrë nëpërmjet Marketingut më të fuqishëm të kohës së sotme.

Internet Marketing është sot për sot ndoshta forma më e thjeshtë edhe për të rinjtë shqiptarë apo profesionistët e marketingut, të cilët duan vërtet të krijojnë një karrierë në profesionet më të kërkuara globalisht.



dhe lehtësisht shumë të targetuar.

Por çfarë është Internet Marketingu realisht?

Ndryshe i quajtur dhe Online Marketing, është procesi i promovimit të një kompanie, brandi, produkti apo një shërbimi të caktuar nëpërmjet Internetit. Ofrimi i këtij shërbimi ka një shtrirje të gjerë duke përfshirë email marketing, menaxhimin e shërbimit ndaj klientit në mënyrë elektronike dhe çfarëdolloj aktiviteti që përfshihet në median online. Gjithashtu është dhe një kombinim i aspektit teknik dhe kreativ i webi-t në mbarë botën, siç janë reklamat, disenjimet, zhvillimet e faqeve dhe shitjet.

Online Marketing është ndarë në disa lloje të ndryshme praktikimi:

- Affiliate Marketing (Marketingu i Ndërmjetësimit të shitjeve të produkteve apo shërbimeve të ndryshme online)
- Display Advertising (Shfaqja e reklamave të ndryshme online)
- Email Marketing (Marketingu nëpërmjet postës elektronike)
- Inbound Marketing (Marketingu i brendshëm apo informimi sa më i mirë i “publikut” me informacione të vlefshme rreth kompanisë, brandit apo produktit që po promovohet, duke siguruar cilësinë maksimale për përdoruesit)



Te lexohet me vëmendje dhe të shënohen disa ushtrime te teknikave promovuese!
Shënoni ajo që është me e rëndësishme në fletore .